



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1125 Prot.

Tiranë, më datë 16.09.2022

VENDIM
Nr. 460, datë 16.09.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 16.09.2022:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për Projektin “Rikonstruksion objekti, ndërtim muri” Brenda kufirit Qendër Historike Gjirokastrë, me aplikues Jorgo Xuhano dhe zhvillues Edmond Lekloti;
 - o Projekti duhet të jetë i qartë grafikisht, me plotësim të detajeve për të gjitha elementet arkitektonike në fasadë të bazuar në materialet grafike të objektit para se të prishej;
 - o Nga krahasimi i kuotave të projektit objektit para prishjes vërehet një diferencë prej 20cm ndërtesa e propozuar më e lartë, duke mos u kuptuar si ndikon kjo rritje e lartësisë tek ndërtesa kufitare;
 - o Projekti të plotësohet dhe me pamje panoramike 3dimensionale të rindërtimit të objektit, e shprehur dhe me fotomontazh në raport me ndërtesat kufitare.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

